



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 99, datë 29.02.2024

“PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR GJYQTARES {...}”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 29.02.2024, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “*Mbi kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar për arsye familjare*”, përgatitur nga relatorja, znj. Irena Plaku, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES

Më datë 30.01.2024 Znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, ka paraqitur “*Kërkesë për leje të papaguar për periudhë: 3 prill 2024 – 3 qershor 2024*”, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 624 prot, datë 30.01.2024.

Në kërkesën me shkrim Znj. {...}, parashtron rrethanat familjare mbi të cilat bazohet kërkesa për leje të papaguar, duke evidentuar faktin se ka dy fëmijë të mitur (binjakë) të cilët ende nuk kanë mbushur moshën 1 vjeç , të cilët kërkojnë përkujdesje të veçantë nga ana e saj dhe se nuk ka asnjë familjar tjetër që mund të përkujdeset për ta, përpara se t’i çojë në qerdhe.

Sa i përket arsyeve konkrete për të cilat kërkohet dhënia e lejes së papaguar, znj. {...}, ndër të tjera, parashtron se : “*...Paraqes këtë kërkesë për të përfituar leje prindërore të paguar për një periudhë 2 mujore në përputhje me nenin 24/3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon “Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme sipas kërkesës së magjistratit”. Arsyeja e paraqitjes së një kërkesë të tillë është nevoja për t’u përkujdesur edhe për një kohë shtesë (2 muaj) për fëmijët e mi, pasi aktualisht ata janë shumë të vegjël, 9 muajsh në kohën e paraqitjes së kërkesës dhe do të jenë 11 muajsh në kohën kur lind detyrimi për t’u kthyer në punë. Në*

kushtet kur bashkëshorti im punon me kohë të zgjatur dhe familjarët tanë janë në marrëdhënie pune dhe për rrjedhojë në pamundësi të na ndihmojnë, jam e detyruar që fëmijët t'i çoj në çerdhe... Për këtë arsye kërkoj nga Këshilli të miratojë kërkesën time për të përfituar leje prindërore të papaguar nga data 3 prill 2024 deri në datën 3 qershor 2024.”

Bashkëlidhur kërkesës me shkrim, znj. {...} ka paraqitur dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

- (i) *Certifikatë familjare, datë 28.12.2023, lëshuar nga Njësia Administrative nr.5, Tiranë.*

II. PROCEDURA E ZHVILLUAR

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtares {...}, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 72, datë 20.02.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, i kërkoj i Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve të kësaj gjykate si dhe mendimin e tij lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës. Gjithashtu, i kërkoj kancelarit të gjykatës, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjyqtares {...}.

Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, **Tiranë**, nëpërmjet postës elektronike, datë **13.02.2024**, ka përcjellë mendim, duke parashikuar ndër të tjera se; “*Ju sqarojmë se në Dhomën Penale për vitin 2023 kanë qenë 21 gjyqtarë, të cilët kanë pasur një mesatare prej **850 çështje** në gjykim për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, duke marrë parasysh edhe gatishmërinë e këtyre gjyqtarëve. Kjo situatë vjen si pasojë e numrit të vogël të gjyqtarëve në këtë dhomë, si dhe volumit të madh të çështjeve.*

Gjyqtare {...} me vendim të KLGJ është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në datë 20.10.2023 periudhë kjo kur gjyqtarja ka qenë dhe vazhdon të jetë me leje lindje dhe për sa i përket lejes prindërore të papaguar e lëmë në vlerësimin tuaj.

Gjithashtu duke pasur parasysh që organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka 80 gjyqtarë por në fakt janë 48 gjyqtarë kërkojmë nga ana juaj që të na plotësohen këto vende vakante”.

Sa i përket ngarkesës aktuale të gjyqtares {...} dhe gjyqtarëve të tjerë, sipas të dhënave të dërguara nga kancelari e gjykatës, nëpërmjet postës elektronike më datë 07.02.2024, rezulton se:

1. Gjyqtarja {...}, nuk ka çështje në shqyrtim, pasi ka përfituar nga e drejta e barrëlindjes më datë 18.04.2023;
2. Ngarkesa mesatare aktuale e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, është 204 çështje për gjyqtar.

Sa i përket organikës së gjykatës, ka rezultuar se Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e ka organikën me 80 gjyqtarë, por aktualisht ushtrojnë funksionet pranë kësaj gjykate vetëm 49 gjyqtarë, kjo për shkak se: se disa gjyqtarw janë shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke qenë ende të pezulluar, një gjyqtare është pezulluar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Por, megjithatë me vendimet e datës 20.02.2024, nga Këshilli janë hapur 9 procedura të tjera për lëvizje paralele për pozicione të lira të përhershme.

Nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, veç kërkesës së gjyqtares dhe provave bashkëngjitur saj, u administruan të dhënat e dosjes personale të gjyqtares.

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarinë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me pikën VI të Vendimit Nr. 72 dt. 20.05.2019 “*Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor*”, brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës së gjyqtares dhe përgjigjes nga ana e Zv/Kryetarit të gjykatës, dhe në mbledhjen e datës 19.02.2024 vendosi që kjo çështje t’i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

Kjo kërkesë u mor në shqyrtim në Mbledhjen Plenare të Këshillit më datë 29.02.2024, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të Vendimit nr.72 datë 20.05.2019 të KLGJ.

III. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Në nenin 24, paragrafi 3 i ligjit 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*”, përcaktohet se: “3. *Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme sipas kërkesës së magjistratit*”.

Në vendimin nr. 72 datë 20.05.2019 për “*Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor*”, përcaktohen kriteret dhe procedurat e dhënies së këtyre lejeve. Lidhur me kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për arsye familjare dhe/ose shëndetësore, pika 8 e vendimit të sipërcituar parashikon si vijon:

- ... 8. *Leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet, jepet nga Këshilli, si më poshtë:*
 - a. *Gjyqtari që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Në rast të nevojave urgjente kërkesa paraqitet menjëherë pa vonesë. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes dhe afatin e lejes së kërkuar. Kërkesës duhet t’i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës;*

- b. *Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit;*
- c. *Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por në total jo më shumë se 2 vjet. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim;*
- ç. *Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.*

IV. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Ligji për Statusin, si pjesë e garancive të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës që kanë për qëllim të sigurojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor, përveç pushimeve vjetore, ka parashikuar edhe të drejtën e magjistratit për të përfituar pushime të tjera. Në këtë kontekst neni 24 i këtij Ligji ka si qëllim që, nëpërmjet përcaktimit të llojeve të pushimeve të tjera dhe rregullave për marrjen e tyre, të krijojë kushtet e përshtatshme për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, i cili nuk është privilegj apo qëllim në vetvete, por i shërben garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër dispozita ka pasur si qëllim të mbrojë edhe të drejtën e marrjes së pushimeve të tjera nga magjistratët, veç lejen e tyre vjetore, duke e parashikuar një të drejtë të tillë drejtpërdrejt në ligj, çka e bën atë element të garancive funksionale për magjistratët.

Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 i Ligjit nr.96/2016 dhe Vendimi nr.72 datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4, parashikojnë tre lloje të lejes dhe konkretisht :

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. **Leje për arsye familjare** dhe/ose shëndetësore;

Në kërkesën e tij, Znj.Çabej parashtrohet se kërkohet leje e papaguar për arsye familjare, sipas përcaktimeve të nenit 24, paragrafi i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Sa i përket kushteve për dhënien e lejes për arsye familjare, sipas parashikimeve të pikës 8 të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në rastin konkret, rezulton se:

1. leja e kërkuar është për një periudhë më pak se 2 vjet, e konkretisht për 2 muaj nga data 03.04.2024 – 03.06.2024;
2. gjyqtarja ka paraqitur kërkesën me shkrim më datë 30.01.2024, ndërkohë që leja kërkohet të fillohet në datë 03.04.2024, pra *kërkesa është paraqitur më shumë se 30 ditë para kohës së fillimit të afatit për të cilin kërkohet dhënia e lejes;*

3. në kërkesën e gjyqtares përcaktohet qartë arsyeja e lejes, e konkretisht për arsye familjare sipas përcaktimeve të nenit 24/ 3 të ligjit 96/2016. Gjithashtu, është përcaktuar qartë kohëzgjatja e lejes, duke kërkuar leje për një periudhë më pak se dy muaj, duke filluar nga data 03.04.2024 – 03.06.2024;
4. kërkesa e gjyqtares {...} është shoqëruar me dokumentacion justifikues. Gjithashtu është paraqitur mendimi me shkrim i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në të cilin, ndër të tjera, theksohet se: “Gjyqtare {...} me vendim të KLGJ është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në datë 20.10.2023 periudhë kjo kur gjyqtarja ka qenë dhe vazhdon të jetë me leje lindje dhe për sa i përket lejes prindërore të papaguar e lëmë në vlerësimin tuaj. Gjithashtu duke pasur parasysh që organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka 80 gjyqtarë por në fakt janë 48 gjyqtarë kërkojmë nga ana juaj që të na plotësohen këto vende vakante”. Lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, veç mendimit të zëvendëskryetarit parashtruar më sipër, është administruar informacion lidhur me ngarkesën aktuale të gjyqtares nga e cila rezulton se ajo nuk ka çështje në shqyrtim, pasi ka përfutur nga e drejta e barrë lindjes më datë 18.04.2023.

Për sa më sipër, vlerësohet se:

1. kërkesa e gjyqtares {...} për leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë dy mujore nga data 03.04.2024 – 03.06.2024, përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24, të ligjit nr. 96/2016 dhe vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.
2. arsyeja për këtë leje, e paraqitur nga gjyqtarja, është e pranueshme, pasi lidhet drejtpërdrejtë me të drejtën e saj për jetë familjare. Kjo e drejtë i garantohet asaj, si çdo shtetasi, nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
3. mungesa e gjyqtares në ushtrimin e funksionit të tij pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për shkak të ngarkesës që ka e gjithë gjykata në tërësi si dhe numrin e gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën në këtë gjykatë, **nuk vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.**

Sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat gjyqtarja {...} ka në shqyrtim në kreun VII, pika 8, shkronja ç) të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019, parashikohet se :”Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim”. Referuar të dhënave statistikore të përcjellë nga kancelari e gjykatës, rezulton se gjyqtarja nuk ka çështje në shqyrtim duke qenë se është me leje barrë lindje dhe është emëruar në këtë gjykatë ndërkohë që ishte me leje.

V. KONKLUZIONI

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtares {...} për dhënien e lejes së papaguar për arsye familjare, për një periudhë nga data 03.04.2024 deri në datën 03.06.2024, përmbush kriteret e

përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 96/2016, si dhe vendimit nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” dhe si e tillë duhet të pranohet.

Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit nr.115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61, 68 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një periudhë dymujore, nga data 03.04.2024 – 03.06.2024.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR